

# KARAKTERI PËRBASHKUES I STRUKTURËS GJUHËSORE TË SHQIPES, SI DHE RUAJTJA E FJALËS SHQIPE NGA HUAZIMET E PANEVOJSHME

Behar HOXHAJ<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Faculty of Philology, University of Prishtina "Hasan Prishtina"

---

## Përmbledhje

Në këtë artikull shprehim pikëpamjen tonë mbi karakterin përbashkues të shqipes standarde në "epokën" e globalizmit si dhe ruajtjen e kësaj gjuhe nga huazimet e panevojshme. Theksin e vëmë në periudhën pas zhvillimeve të viteve '90. Bëhet fjalë jo vetëm për standardin si të tillë, më vete, por edhe për varietetet e tjera të shqipes, për ato të folme të të gjitha trojeve ku flitet shqip, si në Shqipërinë e kufijve politikë, ashtu edhe në shtetin tjetër shqiptar, në Kosovë, por edhe në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në diasporë. Edhe pse një shqipe standarde me moshë rreth 50-vjeçare, ia ka arritur të realizojë në njëfarë mënyre bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga larmia e varieteteve të shqipes që fliten në gjithë arealin shqiptar.

Janë disa faktorë, të cilët ishin frenues dikur, por që pas viteve '90 ndikojnë ndryshe, prej këtej rrjedh edhe ndryshimi i konceptit klasik të dialekteve, si pasojë e presionit të standardit aktual në një anë, por edhe e krijimit të dy shteteve shqiptare, e rritjes së hapësirës së tolerancës. Kjo, edhe në një gjendje ku shqipja është në përballje me gjuhët e tjera, si në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës, në Mal të Zi. Këta faktorë, shumica e tyre jashtëgjuhësorë, kanë pasur ndikim harmonizues për konvergencën natyrore të gjuhës me konvergencën e shqiptarëve në të gjitha aspektet e funksionimit të tyre: atë politik, shoqëror, ekonomik, kulturor, sportiv etj.

---

## Karakterit përbashkues i strukturës gjuhësore të shqipes

Në këtë artikull mëtojmë të shprehim një pikëpamje mbi karakterin përbashkues të shqipes standarde në "epokën" e globalizmit. Më konkretisht, theksin e vëmë në periudhën pas zhvillimeve të viteve '90 e këtej. Për të qenë më të saktë, bëhet fjalë jo vetëm për standardin si të tillë, më vete, por edhe për varietetet e tjera të shqipes, për ato të folme të të gjitha trojeve ku flitet shqip, si në Shqipërinë e kufijve politikë, ashtu edhe në shtetin tjetër shqiptar, në Kosovë, por edhe në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi dhe në diasporë. Në fakt, tipari i parë e kryesor (i gjuhës standarde – B. H.) është përbashkësia dhe përgjithshmëria, çka do të thotë se ajo është një gjuhë letrare e përbashkët dhe e përgjithshme, d.m.th. e përdorshme domosdoshmërisht nga të gjithë kombasit a shtetasit.<sup>51</sup>

---

<sup>51</sup> M. Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 28.

Në kuadrin e 50-vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit, edhe më të shumta janë veprimtaritë, studimet apo përpjekjet e studiuesve nga të gjitha krahinat shqiptare, brenda dhe jashtë kufijve shtetërorë aktualë të Shqipërisë, për të rigjallëruar edhe një herë çështjen e gjuhës shqipe, qoftë edhe duke e përkujtuar atë si një nga arritjet më të mëdha në gjuhësinë shqiptare, në gjuhë e rrjedhimisht edhe në aspektin kombëtar. Por, pavarësisht se këto përpjekje duhet të jenë të vazhdueshme, në çdo kohë, meritojnë vlerësimin e çdo shqiptari, veçanërisht në periudhën në të cilën jetojmë sot.

Rilindësit i kënduan, duke i thurur vargje të zjarrta, gjuhës shqipe. Jo vetëm e lartësuan, por edhe e përdorën dhe e lëvruan këtë gjuhë në të dyja dialektet, madje ka pasur raste që i njëjti autor të ketë shkruar në të dyja dialektet. Mjafton të citojmë disa vargje nga vepra të ndryshme, nga autorë toskë, të cilët kanë përdorur atë që po shndërrohet në një nga çështjet më të mprehta e delikate të debateve për gjuhën standarde, paskajoren gege, të cilën e gjejmë jo vetëm te shkrimtarë gegë, por edhe toskë, siç janë Naim Frashëri apo Mihal Grameno:

Naim Frashëri, “Istori e Skënderbeut”

*Të munjam të fluturonja e të kishnjam krahë si ti,  
Me gas të math do t'i vinjam Shqipërisë brënda në gj!  
Për me marrë drejt Shkumbinë edh' Elbasan' e Tiranën,  
E me ardh ke ti, o Shkodrë, të shof Drinin e Bujanën,  
Kostur, Përlep, Fëllërinë, Dibrë, Ipek e Jakovën,  
Mat' e Ysqyp e Prështinë dhe Mirëdit' e Tetovën;  
Krojënë e Skënderbegut, q'i ka pas dhan ner Shqypnisë,  
Tue bam me trimni luftë, e m' e munt mren e Tyrqisë.*

Mihal Grameno, “Për mëmëdhenë”

*Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë  
Vraponi burra, se s'ka me pritë!*

Por edhe te Faik Konica (*Nuk mundena me pushue së foluni kundër koineve (politikave) qi duen me e tretë e me përpi këtë komb të dashun*), tek Asdreni (*me ardhë, me dhanë, me pa, me pru, me përtri, me luftue, me coptu, me shkëlzy, me shpëtumun, me ditur, me gjetur, me shkëlqyer, me kërkuar etj.*).<sup>52</sup>

Një traditë kjo e shkëlqyer, e cila vijoi edhe më pas. Mund të thuhet se edhe në vitet 1912-1939, konvergjenca gjuhësore, si prirje objektive e gjuhës sonë kombëtare dhe si shprehje e qëndrimit të lëvruarve e studiuesve atdheadashës të gjuhës shqipe në përgjithësi, vazhdoi të thellohej. Përmbajtja thelbësore e kësaj vije përbashkuese (konvergjence) kishte njëkohësisht karakter kombëtar dhe politik e demokratik.<sup>53</sup> Edhe më përpara kësaj periudhe të fillimeve të shtetit shqiptar, përpjekjet për bashkim, kombëtar dhe gjuhësor, kanë qenë të mëdha, por edhe frytdhënëse. Një fakt i pamohueshëm për këtë është edhe miratimi i alfabetit në Kongresin e Manastirit, i cili çeli udhën për standardizimin e shqipes.<sup>54</sup> Edhe pse alfabeti i parë shqip zë fill me Buzukun, për shkaqet historike që dihen, ky alfabet nuk qe e mundur të modifikohet në shekujt e mëvonshëm, siç kanë bërë popujt e tjerë me alfabetet e tyre.

<sup>52</sup> Nuhi Veselaj, *Pse “po” paskajorja në standardin e shqipes së natyrshme*, <http://www.zemrashqiptare.net/news/55504/nuhi-veselaj-pse-po-paskajorja-ne-standardin-e-shqipes-se-natyrshme-2.html>

<sup>53</sup> Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 71-72.

<sup>54</sup> R. Memushaj, *Për shqipen standarde I - Çështje të normës morfologjike dhe drejtshkrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012, f. 211.

Barra për të përfunduar ngrehinën e pambaruar të alfabetit i ra Kongresit të Manastirit dhe në këtë moment të përfundimit të alfabetizimit të shqipes as mund të shtrohej çështja e ndjekjes së shembullit të vendeve europiane. Me rëndësi të madhe që orientimi nga kultura perëndimore, e mishëruar në marrjen si bazë të alfabetit latin.<sup>55</sup> Pas arritjes së parë të madhe të gjuhës dhe gjuhësisë shqiptare, me miratimin e alfabetit, nuk vonoi edhe një tjetër arritje, siç ishte Komisia Letrare e Shkodrës, nisma e parë për standardizimin e gjuhës shqipe, e cila do të vinte në përfundimin se shkrimi i gjuhës shqipe të bazohej në të folmen e Elbasanit, pikërisht aty ku është kufiri i dy dialekteve të shqipes, gegërishtes dhe toskërishtes.

Vetëdija e lartë atdhetare e anëtarëve të Komisionit, por edhe intelektuale e tyre bëri që ata ta vlerësonin si duhej rolin dhe rëndësinë e një gjuhe standarde, pasi standardi i një gjuhe është ai varietet që qëndron si një tërësi për kombin dhe për institucionet e tij më të larta qeverisëse, të arsimit dhe kulturës në përgjithësi... që ndihmon në bashkimin e individëve.<sup>56</sup> Prandaj edhe për këtë arsye, koha e sollë që për hir të nevojës nacionaliste të vlerësohej edhe një herë çështja e shqipes standarde.

Në Shqipëri gjer më 1972 ishin përdorur krahas njëri-tjetrit tri variante letrare: toskërishtja, gegërishtja qendrore dhe gegërishtja veriperëndimore. Por në këtë kohë në Kosovë, ku si gjuhë zyrtare rajonale përdorej varianti verior, dolën në plan të parë nevojat nacionaliste, vlerësimi i gjuhës si shenjë e identitetit kombëtar përballë përpjekjeve të serbëve për ndarjen e Kosovës nga trangu etnik dhe për asimilimin e popullsisë shqiptare. Si rrjedhim, edhe atje u pranua si gjuhë zyrtare toskërishtja, e cila mori përsipër përmbushjen, krahas funksioneve nacionaliste, edhe të funksionit nacionalist: *dallimin prej kombësive të tjera të ish-Jugosllavisë dhe bashkimin me trangu mëmë*.

Vendimi i Konsultës së Prishtinës të vitit 1968 për të përdorur gjuhën zyrtare të shtetit amë si gjuhë letrare të Kosovës u pranua më 1972 nga Kongresi i Drejtshkrimit,<sup>57</sup> kur u vendos që ai projekt të zbatohet masivisht e pa asnjë mëdyshje edhe në trevat shqiptare në ish-Jugosllavi, duke dalë me moton e njohur atdhetare “Një komb - një gjuhë”.<sup>58</sup> Siç e thamë edhe në fillim, gjuha shqipe - standarde dhe dialektet e saj - përveç veçorive të saj dhe rolit që ka luajtur dhe luan sot e kësaj dite, ka edhe karakterin përbashkues të strukturës së saj ndërmjet shqiptarëve të të gjitha trevave apo edhe më gjerë, në diasporë kudo në botë. Kjo do të thotë se shqipja ia ka dalë me sukses të ruajë e të zhvillojë një nga tiparet kryesore të saj: përbashkimin e të gjithë shqiptarëve në një komb. Këtë e ka arritur falë disa elementeve përbashkuese, të cilat do t’i analizojmë më poshtë.

## I. Konvergenca dhe natyraliteti i gjuhës

Pavarësisht nga copëzimi në disa shtete, trysnia amnore ka çuar drejt bashkimit të të gjithë shqiptarëve brenda normës së natyrshme të gjuhës shqipe, si një të tërë, që përfshin standardin bashkë me dialektet apo çdo varietet tjetër të shqipes. Standardi, si normë, duhet të funksionojë brenda normës objektive të gjithëgjuhës. Këtë e ka përmendur edhe Sh. Rrokaj, i cili shprehet se është pikërisht zgjerimi i këtij standardi drejt gjithëgjuhës që do të thotë se karakteri njësuës a njohës i idiomës gjuhësore duhet të zgjerohet drejt asaj që quhet gjuha shqipe. Kjo do të thotë se standardi duhet të pranojë natyrshëm për nevojat e veta prurje nga gjithëgjuha, kryesisht nga trevat jashtë kufirit politik të Shqipërisë.<sup>59</sup>

<sup>55</sup> Po aty, f. 211.

<sup>56</sup> J. A. Fishman, *Sociolinguistics : A Brief Introduction*, Newbury House Publishers, Massachusetts, 1971, f. 31.

<sup>57</sup> R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 328.

<sup>58</sup> Gj. Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 60.

<sup>59</sup> Sh. Rrokaj, *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe në zgjerimin e standardit*, në Çështje të gjuhës 3, Arbëria, Tiranë, 2014, f. 51.

Norma natyrore me varietetet e saj dhe norma e standardit nuk duhen parë si gjedhe që përplasen dhe kërkojnë të eliminojnë njëra-tjetrën. Ato nuk duhen parë as edhe nga këndvështrimi se cila prej tyre është koine prestigji, por si një ecejak i pandërprerë me prirje përfruese dhe bashkëvepruese në të mirë të çka është gjuha natyrore e folësve në një prerje sinkronike të caktuar... Norma në përdorim është produkt i bashkëveprimit të tyre. Kështu që norma e standardit nuk mund të mbetet e pandryshuar në rregullat e vendosura, por në mënyrë të herëpashershme duhet të përputhet me mënyrën si flasin realisht folësit, pra me normën në përdorim.

Prandaj hartimi i korpuseve gjuhësore të shkruara dhe gojore që mundësojnë një perceptim real të përdorimit të standardit është rruga e duhur për të ndërtuar politika gjuhësore shkencore që përjasin gjithë gjuhën me standardin.<sup>60</sup> Njerëzit, në fund të fundit, janë pjesë e natyrës dhe duhet të përshtaten në modelet e saj dhe prishja e këtyre modeleve do të thotë heqje e sistemit të mbështetjes njerëzore.<sup>61</sup> Por çfarë janë këto norma dhe sa i shërbejnë ato njeriut, individit të një bashkësie të caktuar? A janë të ligjëruara këto norma nga pikëpamja e natyralitetit njerëzor dhe sa nevojiten ato?

Ekzistojnë ligje, rregulla, norma për sjelljen e përgjithshme, por edhe për gjuhën dhe përdorimin e saj. Brenda kuadrit të “sjelljes” dhe të shfaqjes së një edukate e kulture të caktuar, ka edhe disa norma gjuhësore, të cilat duhet të zbatohen nga të gjithë anëtarët e një bashkësie gjuhësore. Ideja e normës dhe e thyerjeve të saj (të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme) është me rëndësi në jetën shoqërore e kulturore të një populli. Kultura e gjuhës është pjesë përbërëse e shprehëse e kulturës kombëtare të përbashkët të një populli, prandaj dhe normat gjuhësore i shërbejnë përmirësimit dhe rritjes së peshës ndikuese të kulturës së gjuhës në kuadrin e përgjithshëm të kulturës të një populli.<sup>62</sup>

Pra, në një anë kemi gjuhën apo normën e natyrshme të gjuhës; në anën tjetër janë normat që nuk duhen thyer, të cilat vendosen duke ndërhyrë në gjuhën e një bashkësie të caktuar. Ndërsa mendohet që zhvillimi normal i një gjuhe ndodh në mënyrë fare rastësore dhe për më tepër në nënvetëdijen e folësve, gjuhët standarde janë produkt i një ndërhyrjeje të drejtpërdrejtë dhe të paramenduar nga ana e shoqërisë.<sup>63</sup> Që nga antikiteti i hershëm, me çfarë evidentohet nevoja njerëzore për rregull, ka pasur një lëvizje të vazhdueshme për të krijuar ligje, thënë ndryshe, rregulla të cilat ndihmojnë në krijimin e komunikimit dhe marrëveshjes sociale në nivelet e veta, herë të dobishme dhe herë jo të tilla.<sup>64</sup>

Dhe, komunikimi është funksioni kryesor i këtij kodi që e quajmë gjuhë, funksion i cili mbizotëron, sipas nesh, në situatat e tilla kur është i nevojshëm përcimi i mesazhit nga dhënësi të marrësi. Kështu edhe sa u përket folësve të dy a më shumë dialekteve të një gjuhe, madje edhe folësve të gjuhëve të ndryshme. Megjithatë, standardi duhet kuptuar edhe si diçka që përdoret për të komunikuar lehtësisht me këdo.<sup>65</sup> Koncepti “gjuhë standarde” është disi i turbullt, por një gjuhë standarde tipike, sipas Hudson-it, duhet të kalojë nëpër disa procedura, siç janë: përzgjedhja, kodifikimi, kultivimi i funksionit dhe pranimi.<sup>66</sup>

<sup>60</sup> Sh. Rrokaj, “Këndvështrimi i Demirajt për standardin si proces dinamik, qasje e duhur për një reformë gjuhësore të pritshme”, në Shaban Demiraj, personaliteti i gjuhësisë, arsimit dhe i kulturës shqiptare : akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë, Pegi, Tiranë, 2020, f. 170.

<sup>61</sup> Shih: A. Memia, *Njeriu dhe natyra në globalizëm - (Rasti Shqipëria) - Teoritë liberale të majta, konservatore dhe media*, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Akademia Diplomatike Shqiptare, Forumi Imazh & Media, Tiranë, 2010, f. 134.

<sup>62</sup> Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 51.

<sup>63</sup> (R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 43.

<sup>64</sup> A. Memia, *Njeriu dhe natyra në globalizëm - (Rasti Shqipëria) - Teoritë liberale të majta, konservatore dhe media*, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Akademia Diplomatike Shqiptare, Forumi Imazh & Media, Tiranë, 2010, f. 155.

<sup>65</sup> Shih: M. Meyerhoff, *Introducing Sociolinguistics*, Taylor & Francis Group, 2018, f. 18-19.

<sup>66</sup> R. A. Hudson, *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002, f. 43-44.

Duke iu rikthyer edhe një herë konceptit të natyralitetit të gjuhës, sjellim në vëmendje edhe një vërejtje nga J. Lyons, i cili u kundërpërgjigjet atyre që flasin për primitivitetin e gjuhës, për mitin e gjuhëve të disa popujve që kanë vetëm qindra fjalë dhe komunikimin e plotësojnë me gjepte. Në të vërtetë, sipas tij, çdo gjuhë e studiuar deri më tani, pavarësisht se sa primitive apo e paqytetëruar mund të na duket shoqëria që e përdor atë në aspekte të tjera, pas hulumtimit është dëshmuar se është një sistem komunikimi kompleks dhe shumë i zhvilluar.

Gjithashtu, ai thekson se nuk i takon gjuhëtarit të shprehet mbi vlefshmërinë e evolucionit kulturor të bashkësive njerëzore. Ajo që ai mund të thotë (pra, gjuhëtari – B. H.) është se ende nuk është zbuluar një lidhje midis fazave të ndryshme të zhvillimit kulturor nëpër të cilat kanë kaluar shoqëritë dhe llojit të gjuhës së folur në këto faza të zhvillimit kulturor.<sup>67</sup>Në kundërshtim me pikëpamjen e zakonshme se çdo gjuhë përbëhet nga një dialekt “korrekt” nga i cili largohen të gjitha dialektet e tjera “inferiore” ose “nënstandarde”, të gjitha dialektet janë ekuivalente gjuhësore. Ky keqkuptim ka lindur nga stereotipat dhe paragjykimet sociale.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet se përdorimi i ndonjë dialekti të caktuar nga një person nuk është një pasqyrim i inteligjencës ose gjykimit të tij/saj. Nga pikëpamja gjuhësore, asnjë dialekt apo gjuhë nuk është më e mirë, më e saktë, më sistematike apo më logjike se çdo tjetër. Përkundrazi, çdo varietet gjuhësor është një sistem i qeverisur nga rregullat dhe një mjet efektiv komunikimi.<sup>68</sup>Edhe në rastin, tonë, sipas Sh. Demirajt, secili nga të dy dialektet e shqipes i kishte parakushtet për t’u vënë në bazë të gjuhës letrare të njësuar”.<sup>69</sup>Edhe A. Xhuvani është shprehur se çdo dialekt e ka fuqinë, i ka cilësitë për t’u bamë gjuhë e përbashkët shkrimi për një popull, por rrethanat shoqërore e bien punën që vetëm një dialekt prej shumë dialekteve të një vendi të dalë sipër të tjerëve e të bahet gjuhë e përbashkët letrare, gjuhë kombëtare.<sup>70</sup>

Si çdo dukuri njerëzore, edhe ndaj gjuhës duhet bërë kujdes, duke e trajtuar me “delikatesë”, qoftë edhe kur bëhet fjalë për standardizimin e saj në kuadër të planifikimit gjuhësor, duke qenë të vëmendshëm në rastin e parashkrimit të gjuhës, sepse, siç e thekson studiuesja K. Jorgaqi, parashkrimi (preskriptimi), njësimi i shpejtë, me çdo kusht dhe i gjithçkaje i bie ndesh gjuhës si një dukuri njerëzore, ku situatat e paqëndrueshme ose konfliktuese janë një tipar i brendshëm (intrinsic) i saj.<sup>71</sup>

Megjithëse pa ekzistencën e standardit mund të mos ketë njohuri të mjaftueshme të përbashkëta që gjuha të përmbushë në mënyrë efektive funksionin e saj komunikues, në fund të fundit, çdo deklaratë (rezolutë) e rregullave dhe kongreseve për të folurit dhe të shkruarit duhet të pasqyrojë mënyrën se si përdoret në të vërtetë gjuha.<sup>72</sup>Standardi nuk është i vetmi variant me anë të të cilit arrihet komunikimi njerëzor.

Pavarësisht se gjuha standarde përdoret sot pa asnjë mëdyshje në të gjithë praktikën shkrimore e botuese, si dhe në komunikimin formal (zyrtar) nga e gjithë media në gjuhën shqipe në Tiranë, në Prishtinë dhe në të gjitha stacionet radiotelevizive që emetojnë shqip në mbarë botën, që nga Radio Vatikanin në Romë tek “Zëri i Amerikës” në Uashington, tek “BBC” në Londër e deri në Pekin... nuk do të thotë aspak që në të (në një bashkësi gjuhësore – B. H.)

<sup>67</sup> J. Lyons, *Language and Linguistics: An Introduction*, Cambridge University Press, Cambridge, 1981, f. 27-28.

<sup>68</sup> H. Dawson, M. Phelan, *Language files : materials for an introduction to language and linguistics*, twelfth edition, The Ohio State University, 2016, f. 690.

<sup>69</sup> Sh. Demiraj, GJJ, 1992, f. 36, cituar sipas Sh. Rrokajt, “Këndvështrimi i Demirajt për standardin si proces dinamik, qasje e duhur për një reformë gjuhësore të pritshme”, në Shaban Demiraj, personalitet i gjuhësisë, arsimit dhe i kulturës shqiptare : akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë, Pegi, Tiranë, 2020, f. 162.

<sup>70</sup> A. Xhuvani, *Rreth gjuhës letrare kombëtare dhe rreth ortografisë*, në Vepra I, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980, f. 13.

<sup>71</sup> K. Jorgaqi, *Vështrim mbi drejtshkrimin e fjalëve me prejardhje të huaj*, në Propozime për drejtshkrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021, f. 391.

<sup>72</sup> W. O’Grady et al., *Contemporary Linguistics : An Introduction*, Bedford/ St.Martin's, Boston, New York, 1997, f. 7.

pranohet vetëm ai variant: vetëm standardi. Përkundrazi, në çdo tekst të gjuhësisë së përgjithshme e të sociolinguistikës pranohet e shprehet hapur e qartë se bashkësia gjuhësore nuk mund të përkufizohet si përdoruese e vetëm një kodi, e vetëm një varieteti, qoftë ai edhe standardi kombëtar”.<sup>73</sup>

## II. Ndikimi i faktorëve gjeopolitikë në funksionin e gjuhës standarde

Faktorët gjeopolitikë para viteve ‘90 i binin ndesh funksionit të një gjuhe standarde. Disa prej këtyre faktorëve të disfavorshëm janë:

**1. Copëzimi i shqiptarëve në disa shtete.** Pothuajse përgjatë gjysmës së dytë të shekullit XX shqiptarët ishin të ndarë në disa shtete: fillimisht Shqipëri dhe ish-Jugosllavi e më pas: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi. “Shkrirja” e bllokut lindor bëri që të shkriheshin edhe kufijtë politikë të vëllezërve të një gjaku e të dilnin në pah urat lidhëse kombëtare, shpirtërore, etnokulturore etj.

**2. Gjuha e kalsifikuar e periudhës së komunizmit.** Themi kështu, ngaqë në disa tipa ligjërimesh, gjuha shqipe, duke dashur t’i përshtatej perceptimit të dogmës ideologjike marksiste-leniniste, filloi të ngurtësohej e të kalsifikohej në një shtrat të gjerë parafabrikatesh tipike për shprehjen e një vetëdijeje botëkuptimore ad hoc për këtë dogmë.<sup>74</sup> Ndoshta edhe debatet për standardin janë kaq të mprehta, duke qenë se ky mjet universal komunikimi, siç është gjuha, kuptohej vetëm brenda dogmës. Debatet kanë pasur të bëjnë kryesisht me bazën dialektore të standardit: me çfarë u bë mirë dhe çfarë u bë gabim, çfarë u përfshi dhe çfarë u la jashtë, çfarë duhet përfshirë nga gegërishtja dhe çfarë duhet rregulluar brenda vetë standardit.<sup>75</sup>

Gjuha standarde është një varietet i gjuhës kombëtare të një bashkësie gjuhësore, i cili ligjërohet e ngrihet mbi varietet e tjera (origjinarisht të njëjta), sepse në çaste të caktuara historike gjen mbështetjen e forcave sunduese politike dhe institucionalizohet e merr vlerat e një mjete të komunikimi ndërkrahinor, mbarëkombëtar.<sup>76</sup> Standardi shpesh është varieteti i përdorur nga udhëheqësit politikë, mediat dhe folësit nga klasat më të larta socio-ekonomike. Çdo gjuhë ka të paktën një dialekt standard, i cili shërben si mjeti kryesor i komunikimit në të gjitha dialektet.

Të tjerat mund të quhen dialekte jostandarde, por nuk duhet të konsiderohen inferiore. Nga pikëpamja shoqërore, dialekti standard është dialekti i prestigjit dhe i pushtetit. Megjithatë, prestigji i çdo llojllojshmërie të folurit varet tërësisht nga prestigji i folësve që e përdorin atë.<sup>77</sup>

Ndërkaq, mund të flitet edhe për një koncept tjetër, siç është “prestigji i fshehtë”, i cili u referohet më saktë rasteve kur vlerësimi pozitiv i folësve për një variant është vërtet i fshehtë ose i fshehur.<sup>78</sup> Ka edhe një teori tjetër, sipas së cilës standardizimi i gjuhës zakonisht rrezaton, orientohet prej qendrave metropolitane të pushtetit për nga jashtë, drejt periferive, dhe është shpesh rezultat i ndryshimeve apo përmbysejeve dhe riintegritit politik.<sup>79</sup>

<sup>73</sup> Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 65.

<sup>74</sup> Sh. Rrokaj, *Shqipja në epokën e globalizimit dhe identiteti i saj*, në Çështje të gjuhës 2, Shkronjë pas Shkronje, Tiranë, 2009, f. 68.

<sup>75</sup> Sh. Rrokaj, *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe zgjerimin e standardit*, në Çështje të gjuhës 3, Arbëria, Tiranë, 2021, f. 43.

<sup>76</sup> Gj. Shkurtaç, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003, f. 59.

<sup>77</sup> H. Dawson, M. Phelan, *Language files : materials for an introduction to language and linguistics*, twelfth edition, The Ohio State University, 2016, f. 690.

<sup>78</sup> M. Meyerhoff, *Introducing Sociolinguistics*, Taylor & Francis Group, 2018, f. 44.

<sup>79</sup> R. L. Cooper, *Language Planning and Social Change*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989, f. 133.

Prandaj, prej këtej rrjedh edhe disavantazhi i përpjekjes për të zbatuar procesin e standardizimit me vendim zyrtar, pasi kjo i vendos folësit e një varieteti të zgjedhur në një pozitë më të favorshme, nga ana politike dhe shoqërore, sesa folësit e varieteteve të tjera.<sup>80</sup> Por, sipas Fishman-it, ekziston edhe një arsye e thjeshtë pse planifikimi gjuhësor në përgjithësi dhe planifikimi i korpusit në veçanti synojnë më qartë gjuhën e shkruar (zakonisht atë të shtypur) sesa atë të folur. Gjuha e shkruar është pothuajse e kontrollueshme sepse mund të monitorohet nga shkollat, redaktorët, botuesit apo institucionet të tjera drejtuese dhe vlerësuese.<sup>81</sup>

M. Samara është shprehur se në epokën kur krijohen gjuhët letrare kombëtare, të njësuara (standarde), krijohen vetvetiu edhe kushte për shuarjen e dialekteve ose të ndonjë varianti a gjuhe tjetër të dytë (sekondare), së cilës i janë ngushtuar e kufizuar funksionet e saj.<sup>82</sup> Gjithsesi, ai vetë më poshtë thekson se as autoritarizmi, as automatizimi i jetës shoqërore, as zhvillimi i mendimit dhe i shkencës me metoda nga më të sofistikuarat, dhe as ndonjë trysni tjetër jashtënjerezore nuk mund të çojë në mbarimin e gjuhës si dukuri psiko-shoqërore.<sup>83</sup> Dhe kjo vërehet edhe te rasti i gjuhës shqipe dhe i përdoruesve të saj.

Ajo jo vetëm që nuk u shua si gjuhë (qoftë si gjuhë standarde apo gjithëkombëtare), por edhe dialektet apo varietetet e saj krahinore marrin një zhvillim tjetër në periudhën pas viteve '90. Është normale që pas ndryshimeve politike në vendin dhe në kombin tonë, të shtrira jo vetëm në një shtet, edhe gjuha do të pasqyrojë ndryshimet e mëdha gjeopolitike. Nga ana tjetër, studimet gjuhësore kanë pasur mundësi të jenë më të argumentuara shkencërisht, duke u bazuar edhe në një literaturë më të pasur me mjete të një teknologjie më të zhvilluar. Shqipja, në përgjithësi, dhe standardi, në veçanti, duhen diskutuar pikërisht nisur nga këto këndvështrime.<sup>84</sup>

**3. Procesi “paraurban”, një faktor tjetër demografik.** Popullsia shqiptare ka qenë e mbyllur në enklava, brenda territoreve të caktuara, të cilat nuk lejonin komunikimin ndërmjet anëtarëve të një bashkësie gjuhësore siç është ajo e gjuhës shqipe. Jo vetëm ndarje mes shteteve, por edhe brenda territorit të kufijve politik të Shqipërisë vërehej ndarja, moskomunikimi, kjo për disa shkaqe, që nga ato gjeografike e deri tek ato ideologjike e politike.

**4. Trysnia e gjuhëve të tjera,** në një pjesë të madhe të trojeve shqiptare dhe e politikave nacionaliste në këto vende. Kjo dukuri shkon krahas edhe me ndikimin e gjuhëve të tjera, kryesisht anglishtja, në gjuhën shqipe, sidomos tani në kohën e globalizmit. Megjithatë, nuk duhet ngatërruar zhvillimi i sotëm i shoqërisë drejt globalizmit me procesin objektiv a me prirjen drejt krijimit të gjuhëve letrare kombëtare ose ndërkombëtare, sepse gjuhët përmbajnë në thelb më shumë elemente të ndërgjegjes a të shpirtit të njeriut a të popujve, prandaj shpesh dëgjohet të thuhet: “Globalizmi ekonomik e politik është i pranueshëm, por ai nuk mund të identifikohet me globalizmin shpirtëror e gjuhësor”, çka tregon se thirrja në emër të globalizmit nuk do të thotë “shkatërrim” i identitetit gjuhësor ose i integritetit të gjuhës letrare kombëtare, i prirjes për vetëruajtjen e saj.<sup>85</sup>

Globalizmi, epoka jonë, Europa e Bashkuar dhe dukuritë e shoqërisë moderne, që po vërshojnë me forcë në shoqërinë shqiptare, kërkojnë fuqizimin e standardit dhe jo krijimin e standardeve të tjera. Shqiptarët e përhapur anekënd botës kanë nevojë të bashkohen, të komunikojnë. Europa dhe bota kërkojnë një mjet marrëveshjeje, një standard.

<sup>80</sup> J. Lyons, *Language and Linguistics: An Introduction*, Cambridge University Press, Cambridge, 1981, f. 278.

<sup>81</sup> J. A. Fishman, *Do not leave your language alone : the hidden status agendas within corpus planning in language policy*, Lawrence Erlbaum Associates, Mahwah, New Jersey, 2006, f. 6.

<sup>82</sup> M. Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 17.

<sup>83</sup> Po aty, f. 17.

<sup>84</sup> A. Jubani, *Rregullat e drejtshkrimit të shqipes standarde dhe disa trajtesa të diskutueshme*, në Propozime për drejtshkrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021, f. 36.

<sup>85</sup> M. Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 24.

Prandaj përmirësimi dhe zhvillimi i tij, duke përfshirë edhe rishikimin e disa rregullave të drejtshkrimit për të shmangur përjashtimet nga sistemi, është detyrë shkencore e patriotike, përderisa bëhet fjalë për gjuhën e gjithë kombit. Por diskutimi i këtyre problemeve duhet bërë mbi baza shkencore dhe me argumente të mbështetura në ligjet e zhvillimit të gjuhës, pas hulumtimeve të gjata, vrojtimeve dhe studimeve të përimtuara nga specialistë që kanë punuar vite të tëra për të.<sup>86</sup> Siç është thënë edhe në “Drejtshtkrimin e gjuhës shqipe”, duhet pasur parasysh jo vetëm gjendja e sotme të gjuhës sonë letrare, por edhe prirjet kryesore të zhvillimit të saj të mëtejshëm.<sup>87</sup>

### III. Nevojat pragmatike për komunikim dhe funksione të tjera të gjuhës

Një sërë faktorësh të rëndësishëm për karakterin përbakshues të gjuhës standarde lidhen me nevojat pragmatike të folësve për komunikim, një komunikim sa më të shpejtë dhe efektiv. Kjo është bërë më e nevojshme veçanërisht dekadat e fundit. Këto nevoja kanë të bëjnë së pari me shtetet shqiptare (Shqipëri e Kosovë), me entet botuese, kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik-shoqëror, me biznese e kompani të të gjitha llojeve që duan të shtrihen përtej territoreve përkatëse, si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, Maqedoni të Veriut, në Mal të Zi e më gjerë.

1. Shtetet duhet të përkthejnë legjislacionin e BE-së, legjislacionin ndërkombëtar etj. në një standarde të njësuar dhe të kuptueshme e të përdorshme për të gjithë.

2. Shtëpitë botuese, mediat kanë nevoja pragmatike për publikim e komunikim të plotë, të qartë, të shpejtë.

3. Bizneset (që nuk janë konservatore ndaj kufizimit territorial), kanë nevojë që të shtrijnë veprimtarinë e tyre në të gjitha trojet ku flitet shqip.

4. Edhe nevoja për t'u futur në shqipe fjalë nga gjuhë të tjera është pjesë e konvergencës. Sepse, kjo shqipe flitet në të gjitha enklavat, ndaj ndihet nevoja për përthithjen e këtyre fjalëve (natyrisht, kur nuk është i mundur shqipërimi i tyre) në një formë, duke shmangur kështu edhe përdorimin e disa shënjesve për një të shënuar, për hir edhe të ekonomisë gjuhësore.

5. Vetë standardi, zgjerimi i tij, po arrin të shtrihet më gjerë nëpërmjet mediave, shkollës, administratës shtetërore e publike, pse jo, edhe përmes internetit dhe rrjeteve sociale.

Këta faktorë përbashkues (por frenues para '90-ës), pas këtyre viteve fillojnë e shkrihen, dobësohen. Njerëzit lëvizin lirisht, zhvillimi urban (mes të tjerave dhe nga kryesoret Rruga e Kombit), krijimi i shtetit të Kosovës, miratimi i ligjit të pakicave në Maqedoninë e Veriut etj. janë disa nga faktorët që ndikuan pozitivisht e vijojejnë të ndikojnë në këtë mënyrë për zgjerimin e funksionit të gjuhës standarde.

Funksionet shoqërore të shqipes standarde po zgjerohen me shpejtësi edhe në trojet shqiptare jashtë kufijve të Shqipërisë, si edhe në diasporë, në ngulimet arbëreshe etj., me një fjalë në të gjitha vendet ku banojnë e jetojnë shqiptarët.<sup>88</sup> Në këtë aspekt, standardi mbrojtë nga krisja gjuhësore, edhe krisja kombëtare për shkak të copëtimit gjeopolitik të kombit në disa shtete e ku shqipja, sikundër vetë shqiptarët, po formonin një arkipelag gjuhësor pa mundësi komunikimi brendaetnike prej një ishulli gjuhësor tek tjetri.<sup>89</sup>

Edhe pse një standard, po themi, me moshë rreth 50-vjeçare, ai ia ka arritur të realizojë në njëfarë mënyre bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga larmia e varieteteve të shqipes që fliten në të gjithë arealin shqiptar. Megjithatë, kjo larmi duhet të jetë epërsia që duhet shfrytëzuar për pasurimin e standardit.

<sup>86</sup> K. Topalli, *Drejtshtkrimi i shqipes si sistem*, në Propozime për drejtshtkrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021, f. 55.

<sup>87</sup> *Drejtshtkrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973, f. 3.

<sup>88</sup> M. Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 220-221.

<sup>89</sup> Sh. Rrokaj, *A mund të përmirësohen rregullat e drejtshtkrimit të gjuhës shqipe?*, në Propozime për drejtshtkrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021, f. 289.



Vetë larmia demografike e shqipfolësve (të ndarë në disa shtete e me trysni politikash gjuhësore, në të shumtën e rasteve, asimiluese) bën të domosdoshme ruajtjen dhe pasurimin e standardit nëpërmjet përfshirjes gjithmonë e më të madhe të formave të mbarë gjuhës dhe përdorimit të varianteve, të cilat i japin hijeshi mozaikut gjuhësor dhe tregojnë pasurinë e vitalitetin e tij.<sup>90</sup> Siç u theksua edhe më sipër, këta faktorë tani ndikojnë ndryshe, prej këtej edhe ndryshimi i konceptit klasik të dialekteve, si pasojë e presionit të standardit aktual në një anë, por edhe e krijimit të dy shteteve shqiptare, e rritjes së hapësirës së tolerancës.

Kjo, edhe në një gjendje ku shqipja është në përballje me gjuhët e tjera, si në Maqedoninë e Veriut, në Luginën e Preshevës, në Mal të Zi. Në këtë mënyrë, gjuha letrare (standarde) shqipe po bëhet një faktor i rëndësishëm për konsolidimin e njësisë etnokulturore të shqiptarëve, për forcimin e mëtejshëm të unitetit kombëtar e shtetëror, për integrimin dinjitoz e në mënyrë të barabartë të gjuhës e kulturës shqiptare në bashkësinë e kulturave europiane e botërore.<sup>91</sup> Këta faktorë, shumica e tyre jashtëgjuhësorë, kanë pasur ndikim harmonizues për konvergjencën natyrore të gjuhës me konvergjencën e shqiptarëve në të gjitha aspektet e funksionimit të tyre: atë politik, shoqëror, ekonomik, kulturor, sportiv etj.

### **Ruajtja e fjalës shqipe nga huazimet e panevojshme**

Më sipër theksuam trysninë e gjuhëve të tjera, kryesisht të anglishtes, në një pjesë të madhe të trojeve shqiptare, sidomos tani në kohën e globalizmit. Gjithashtu u theksua se nuk duhet ngatërruar zhvillimi i sotëm i shoqërisë drejt globalizmit me procesin objektiv a me prirjen drejt krijimit të gjuhëve letrare kombëtare ose ndërkombëtare, sepse gjuhët përmbajnë në thelb më shumë elemente të ndërgjegjes a të shpirtit të njeriut a të popujve. Ka periudha kur fjalët e huaja depërtojnë me shumicë, p.sh. gjatë pushtimeve, siç ka ndodhur gjatë pushtimit romak, sllav e turk të vendit tonë.

Rreziku i përmytjes së leksikut nga vërshimi i huazimeve nuk është problem vetëm i gjuhëve të vogla... Edhe më i mprehtë është bërë problemi i ndikimeve në leksik veçanërisht në dhjetëvjetëshat e fundit në vendet e Europës Lindore e Juglindore. Kështu, në shqipe, veç huazimeve që kanë hyrë për të emërtuar dukuri dhe koncepte të reja tekniko-shkencore dhe të fushës ekonomike-politike, po përdoren shumë fjalë të huaja krejtësisht të panevojshme, të cilat gjuha shqipe i pat flakur jashtë. Kjo shtron nevojën e pengimit të vërshimit të këtyre barbarizmave, pasi ruajtja e pastërtisë së leksikut lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e pastërtisë së gjuhës kombëtare, që është karakteristika themelore dalluese e kombit.<sup>92</sup>

Gjuha shqipe dëmtohet dhe rrezikohet në radhë të parë nga shpërfillja, nga mungesa e kujdesit të shtetit, nga botimet e paredaktuara e të pakorrektuara, si dhe nga njëfarë ndjenje e përgjithshme nënvlerësi ndaj saj. Shqetësimi bëhet edhe më i madh, kur bindemi se kjo ndodh jo vetëm nga padija, nga mosnjohja e normës, por më tepër nga pakujdesia, nga mospërfillja e rregullave dhe e normave të shqipes standarde, nga mbivlerësimi i së huajës dhe nga nënvlerësimi (ndoshta edhe përçmimi) i kulturës kombëtare në përgjithësi.<sup>93</sup>

Kështu, vihet re një lumë i madh fjalësh të huaja që rrjedh “pa doganë” nga të katër anët e shqiptarisë dhe nga të gjitha anët dhe mjetet e teknologjisë së informacionit. Por, a është e pazonja gjuha shqipe t’i bëjë ballë këtij vërshimi? Absolutisht që gjuha shqipe i ka të gjitha aftësitë të përballit me cilëndo gjuhë, duke filluar që nga ajo angleze. Siç e ka theksuar edhe Gj. Shkurtaj, ndryshe nga kufijtë e normës standarde gramatikore e fonetike, ata të leksikut karakterizohen nga çlirësia, nga përzgjedhja mes njësisë sinonime, nga parapëlqimi i fjalës

<sup>90</sup> Sh. Rrokaj, *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Arbëria, Tiranë, 2012, f. 190.

<sup>91</sup> M. Samara, *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005, f. 224.

<sup>92</sup> R. Memushaj, *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006, f. 195-196.

<sup>93</sup> Gj. Shkurtaj, *Urgjenca gjuhësore : huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe : (fjalorth)*, Botimet Ada, Tiranë, 2015, f. 18.

shqipe përballë fjalës së huazuar, i fjalës së mbarë gjuhës përballë fjalës krahinore etj. Kjo çlirësi e normës leksikore paraqitet kështu si mundësi, si zhdërvjelltësi, si jetësim dhe jo si pengesë a pritë mospranuese, penguese a përjashtuese.<sup>94</sup>

Sipas disa studiuesve fjalët e huaja e pasurojnë gjuhën, sipas të tjerëve ato e prishin dhe prandaj duhen nxjerrë të gjitha nga përdorimi... E vërteta është se fjalët e huaja e prishin gjuhën kur pranohen e përdoren pa nevojë. Nuk duhet të merren e të përdoren fjalë të huaja në gjuhë kur kemi fjalët tona, veçse në ato raste kur ato sjellin një kuptim të ri, një nuancë të re, një ngjyrim emocionues a stilistik etj., që nuk e japin mjetet e vetë shqipes.<sup>95</sup> E nënvizuam edhe më sipër nevojën e ngutshme të dy individëve për komunikim, por kjo nuk do të thotë që duhet të shpërdorojmë një element në kurriz të një tjetri.

I rëndësishëm është komunikimi ndërnerëzor, por rëndësi ka edhe ruajtja e identitetit kombëtar dhe gjuha është një nga faktorët kryesorë të ruajtjes së këtij identiteti, në mos më i rëndësishmi. Ndaj, dhe duhet të jetë detyra e gjithsecilit - gjuhëtar, shkrimtar, krijues apo jo - që ta ruajë me devotshmëri këtë amanet të të parëve tanë si një nga simbolet e gjalla të vazhdimësisë kombëtare shqiptare ndër shekuj.

## Përfundime

Në periudhën pas zhvillimeve të viteve '90 e këtej, vihet re karakteri përbashkues i strukturës së gjuhës shqipe. Jo vetëm standardi, por edhe varietetet e tjera të të gjitha trojeve ku flitet shqip, po shkojnë në njëfarë mënyre drejt përbashkësisë. Kjo gjuhë ia ka dalë me sukses të ruajë e të zhvillojë një nga tiparet kryesore të saj: përbashkimin e të gjithë shqiptarëve në një komb. Këtë e ka arritur falë disa elementeve që kanë të bëjnë me nevojat pragmatike për komunikim dhe funksione të tjera të gjuhës, siç janë: nevojat për të përkthyer legjisacionin e BE-së, legjisacionin ndërkombëtar në përgjithësi etj. në një gjuhë standarde të njësuar, të kuptueshme e të përdorshme për të gjithë; nevojat pragmatike të shtëpive botuese, mediave për publikim e komunikim; nevoja që kanë bizneset që të shtrijnë veprimtarinë e tyre në të gjitha trojet ku flitet shqip; nevoja për t'u futur në shqipe fjalë nga gjuhë të tjera; vetë standardi, zgjerimi i tij, po arrin të shtrihet më gjerë nëpërmjet medieve, shkollës, administratës shtetërore e publike, pse jo, edhe përmes internetit dhe rrjeteve sociale etj.

Këta faktorë përbashkues (por frenues para '90-ës), pas këtyre viteve fillojnë e shkrihen, dobësohen. Njerëzit lëvizin dhe komunikojnë lirisht, duke shkuar drejt asaj që mund të quhet gjuha kombëtare ose gjithëgjuha. Megjithatë, kjo gjuhë që ka mbijetuar pothuajse për dy mijë vjet përballë gjuhëve të ndryshme, gjendet sërish në rrezik për shkak të vërshimeve të fjalëve të huaja të panevojshme. Rreziku vjen në radhë të parë nga shpërfillja, nga mungesa e kujdesit të shtetit, nga botimet e paredaktuara e të pakorrektuara, si dhe nga njëfarë ndjenje e përgjithshme nënvlerësimi ndaj saj.

Kjo ndodh jo vetëm nga padija dhe mosnjohja e normës, por më tepër nga pakujdesia, nga mospërfillja e rregullave dhe e normave të shqipes standarde, nga mbivlerësimi i së huajës dhe nga nënvlerësimi (ndoshta edhe përçmimi) i kulturës kombëtare në përgjithësi. Fjalët e huaja e prishin gjuhën kur pranohen pa nevojë, ndaj nuk duhet të merren e të përdoren kur kemi fjalët tona, veçse në ato raste kur ato sjellin një kuptim të ri, një nuancë të re, një ngjyrim emocionues a stilistik etj., që nuk e japin mjetet e vetë shqipes. Kështu që, është detyrë e të gjithëve që ta ruajmë, ta kultivojmë e ta përdorim si duhet këtë thesar të kombit tonë.

---

<sup>94</sup> Gj. Shkurtaj, *Urgjenca gjuhësore : huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe : (fjalorth)*, Botimet Ada, Tiranë, 2015, f. 50. Shënim: Në këtë libër të Gj. Shkurtajt, lexuesit mund të gjejnë një fjalorth të dobishëm për sa i përket zëvendësimit të huazimeve me fjalë shqipe.

<sup>95</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, ribotim, Tiranë, SHBLU, 2002, f. 234-235.

## Referencat

- [1]. Cooper, R. L., *Language Planning and Social Change*, Cambridge University Press, Cambridge, 1989.
- [2]. Dawson, H., Phelan, M., *Language files : materials for an introduction to language and linguistics*, twelfth edition, The Ohio State University, 2016.
- [3]. Demiraj, Sh., *GJJ*, 1992, f. 36, cituar sipas Sh. Rrokajt, *Këndvështrimi i Demirajt për standardin si proces dinamik, qasje e duhur për një reformë gjuhësore të pritshme*, në Shaban Demiraj, personalitet i gjuhësisë, arsimit dhe i kulturës shqiptare : akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë, Pegi, Tiranë, 2020.
- [4]. *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Akademia e Shkencave, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1973.
- [5]. Fishman, J. A., *Do not leave your language alone : the hidden status agendas within corpus planning in language policy*, Lawrence Erlbaum Associates, Mahwah, New Jersey, 2006.
- [6]. Fishman, J. A., *Sociolinguistics : A Brief Introduction*, Newbury House Publishers, Massachusetts, 1971.
- [7]. Hudson, R. A., *Sociolinguistika*, Dituria, Tiranë, 2002.
- [8]. Jorgaqi, K., *Vështrim mbi drejtskrimin e fjalëve me prejardhje të huaj*, në Propozime për drejtskrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021.
- [9]. Jubani, A., *Rregullat e drejtskrimit të shqipes standarde dhe disa trajtesa të diskutueshme*, në Propozime për drejtskrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021.
- [10]. Lyons, J., *Language and Linguistics: An Introduction*, Cambridge University Press, Cambridge, 1981.
- [11]. Memia, A., *Njeriu dhe natyra në globalizëm - (Rasti Shqipëria) - Teoritë liberale të majta, konservatore dhe media*, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, Akademia Diplomatike Shqiptare, Forumi Imazh & Media, Tiranë, 2010.
- [12]. Memushaj, R., *Hyrje në gjuhësi*, Toena, Tiranë, 2006.
- [13]. Memushaj, R., *Për shqipen standarde I - Çështje të normës morfologjike dhe drejtskrimore*, Infbotues, Tiranë, 2012.
- [14]. Meyerhoff, M., *Introducing Sociolinguistics*, Taylor & Francis Group, 2018.
- [15]. O'Grady, W. et al., *Contemporary Linguistics : An Introduction*, Bedford/ St.Martin's, Boston, New York, 1997.
- [16]. Rrokaj, Sh., *A mund të përmirësohen rregullat e drejtskrimit të gjuhës shqipe?*, në Propozime për drejtskrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021.
- [17]. Rrokaj, Sh., *Hyrje në gjuhësinë e përgjithshme*, Arbëria, Tiranë, 2012.
- [18]. Rrokaj, Sh., *Këndvështrimi i Demirajt për standardin si proces dinamik, qasje e duhur për një reformë gjuhësore të pritshme*, në Shaban Demiraj, personalitet i gjuhësisë, arsimit dhe i kulturës shqiptare : akte të konferencës shkencore ndërkombëtare, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë, Pegi, Tiranë, 2020.
- [19]. Rrokaj, Sh., *Roli i dialekteve në shtrirjen dhe në zgjerimin e standardit*, në Çështje të gjuhës 3, Arbëria, Tiranë, 2014.
- [20]. Rrokaj, Sh., *Shqipja në epokën e globalizimit dhe identiteti i saj*, në Çështje të gjuhës 2, Shkronjë pas Shkronje, Tiranë, 2009.
- [21]. Samara, M., *Histori e gjuhës letrare shqipe (shek. XV-XXI)*, SHBLU, Tiranë, 2005.
- [22]. Shkurtaç, Gj., *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 2003.
- [23]. Shkurtaç, Gj., *Urgjenca gjuhësore : huazime të zëvendësueshme me fjalë shqipe : (fjalorth)*, Botimet Ada, Tiranë, 2015.
- [24]. Topalli, K., *Drejtskrimi i shqipes si sistem*, në Propozime për drejtskrimin I, ALSAR, Tiranë, 2021.
- [25]. Thomai, J., *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, ribotim, Tiranë, SHBLU, 2002.
- [26]. Veselaj, N., *Pse "po" paskajorja në standardin e shqipes së natyrshme*, <http://www.zemrashqiptare.net/news/55504/nuhi-veselaj-pse-po-paskajorja-ne-standardin-e-shqipes-se-natyrshme-2.html>
- [27]. Xhuvani, A., *Rreth gjuhës letrare kombëtare dhe rreth ortografisë*, në Vepra I, Akademia e Shkencave, Tiranë, 1980.